


LAPSI ËSHTË GJUHA E MENDJES



DEMOKRACIA ËSHTË UDHËRRËFYESI YNË

ERSIDA (10), ELSA (10), ELJESA (10), ADONIS (10), RINESA (10), ENJËLL (10), VENIS (11),


DRENUSHA (10)



Në këtë artikull do të gjeni informata për demokracinë, mënyrën se si ne e shohim atë dhe se si e përkrahim zhvillimin e saj

Demokracia do të thotë qeverisje e popullit, nga populli dhe për popullin. Një shtet mund të jetë demokratik, atëherë kur populli i cili jeton në atë shtet, kontribuon në procese demokratike.

Në shtetin tonë, qytetarët e mirë janë ata të cilët mbrojnë shtetin e tyre demokratik. Demokracia funk-



sionon në disa baza themelore. Për shembull, zgjedhjet janë baza e demokracisë. Përmes tyre, qytetarët vetë i zgjedhin përfaqësuesit për ta udhëhequr vendin. Në zgjedhje mund të votojnë qytetarët mbi moshën 18 vjeçare. Arsyeja pse ne fëmijët nuk mund të votojmë është se ende nuk jemi të pjekur mjaftueshëm. Kjo për shkak zgjedhja e përfaqësuesve të vendit kërkon pjekuri. Megjithatë, ne tashmë kemi të drejta të tjera që i gëzojmë si: e drejta për tu shprehur lirshëm, e drejta e

arsimit, e drejta e lojës, etj.

Ne kur arsimohemi përfitojmë dhe sigurojmë të ardhmen tonë Mirëpo, gjithashtu përfiton edhe shteti. Me arsimim ne përgatitemi për profesionet tona të ardhshme. Secili në profesionin e vet do të kontribuojë për zhvillimin e shtetit.

Ne i kemi zgjedhur profesionet tona. Për shembull, Adonisi kur të ketë moshën për të ushtruar një profesion, dëshiron të bëhet polic, sepse ai në këtë mënyrë mendon se do të kontribuojë për shtetin e vet. Eljesa dëshiron të bëhet mësuese, sepse ajo mendon se duke i arsimuar fëmijët, do të përfitojë shteti ynë. Kurse, Venisi dëshiron të bëhet arkitekt, në mënyrë që të projektoj çerdhe dhe shkolla që të arsimohen fëmijët. ndërtesa banimi, etj.

Kur një shtet është i pavarur, qytetarët duhet të jenë të pavarur po ashtu, sepse në demokraci pavarësia e individit është shumë e rëndësishme.



Autorët e artikullit

E DREJTA E ZGJEDHJES NË DEMOKRACI

ZEJNIJE (11), BENJAMIN (11), LEARTA (10), LORIK (11), ERIONA (10), ELTON (10), ANISA (10),

GRAMOS (10)



Në cilën prej këtyre dy lëndëve të shkoj në gara? Që të dy lëndët më pëlqejnë shumë

Të dashur lexues, mos harroni gjithmonë të bëni zgjedhjen më të mirë. Vetëm kështu mund të kemi zhvillim

Sovranitetin mund ta ushtrojmë përmes votës tonë

Sot e ndryshuam ditën tonë, me vizitën që ia bëmë organizatës "TOKA,,. Kjo vizitë lidhet me interesin tonë për të mësuar më shumë për demokracinë. Përveç demokracisë, ne në grup të vogël mësuam edhe për rëndësinë e zgjedhjeve në demokraci. Ne kemi raste të ndryshme ku ne bëjmë zgjedhje, qoftë individuale qoftë zgjedhje grupore.

në dyshim se a ta blinte një libër me poezi, apo një roman. Si përfundim, ajo zgjodhi romanin, sepse ajo është çka Zejnija do më shumë. Siç po e shihni, ne bëjmë shumë zgjedhje në jetë. Sot ne gjithashtu mësuam, se në demokraci, ne kemi shumë të drejta. Një prej këtyre të drejtave është e drejta e zgjedhjes së udhëheqësve të vendit. Prandaj, ne kur ta arrijmë moshën 18 vjeçare, do të mund ta shfrytëzojmë këtë të drejtë dhe do të dalim në zgjedhje. Llojet e zgjedhjeve



Shfrytëzoje të drejtën tënde për të votuar dhe dil e voto



Ne sot zgjodhëm të jemi gazetarë

Gramosi, është shok i klasës sonë. Ai së bashku me familjen e tij, tash së fundmi janë zhvendosur nga fshati, në qytetin e Vushtrrisë.

Prapa kësaj zgjedhjeje, qëndron një arsye e fortë, e ajo është mungesa e ujit në fshat. Kjo situatë i ka detyruar banorët të ndërrojnë vendbanim. Pastaj, shoqja jonë Zejnija, ka një pasion të madh për leximin.

Por një ditë shkuam bashkë në librari dhe ajo ishte

janë dy: zgjedhjet lokale, ku votohet për kryetarin e komunës dhe asamblistët, si dhe zgjedhjet qendrore ku votohet për përfaqësuesit e shtetit të cilët janë deputetët. Sot e kuptuam arsyen se pse zgjedhjet janë kaq të rëndësishme në jetën tonë. Jemi pikërisht ne ata të cilët vendosim për të ardhmen tonë. Ju falenderojmë nga zemra që lexuat këtë artikull.

QYTETARËT AKTIV TË SHTETIT DEMOKRATIK

LEJLJA (10), SUELA (10), FLORENT (10), SEAD (10), ERION (10), ABIT (10), RINESA (11), RINORA (11)



Pse duhet të jemi qytetarë aktiv? Si duhet të aktivizohemi për shtetin tonë? Cilat janë cilësitë e një qytetari aktiv? Të gjithë këto do t'i mësoni në këtë artikull

Ne duhet të jemi qytetarë aktiv, sepse vetëm kështu ndërtohet shteti. Mundësinë për të qenë qytetar aktiv e kemi të gjithë. Mirëpo, sa e marrim parasysh këtë mundësi, mbetet përgjegjësi e secilit prej nesh. Qytetarët aktiv, karakterizohen me disa cilësi. Një ndër

lim kanë të japin ide dhe të bashkohen në mënyrë që t'i realizojnë ato, etj.

Por, si qytetarë aktiv janë të njohur edhe ata qytetarë të cilët i respektojnë rregullat, i zbatojnë ligjet, mësojnë dhe marrin njohuri. Po ashtu, edhe ata të cilët votojnë në moshën e paraparë me ligj. E kemi përmendur votimin, sepse përmes tij përcaktohet e tërë qeverisja e vendit dhe vetëm një votë e qytetarit bënë ndryshim. Edhe ne si nxënës kemi pasur raste kur jemi treguar aktiv. Mendojmë se do të vazhdojmë me të njëtin ritëm, sepse kemi ide të reja se si mund ta bëjmë këtë. Disa nga punët vullnetare që ne i kemi bërë me plot dëshirë janë: pastrimi i oborrit të shkollës, ndihma ndaj nxënësve të cilët kanë pasur nevojë, ndihma ndaj të moshuarve, etj.

Po ashtu, edhe sot jemi qytetarë aktiv, sepse jemi pjesë e projektit „Demos-ti“. E çka nënkuptojmë me këtë? Lexojeni artikullin në vijim të mbushur me informata për ju.



Duke marrë informata për veprimtaritë e qytetarëve aktiv

këto cilësi është kujdesi ndaj të tjerëve si dhe preokupimi për komunitetin ose për vendin se ku jetojnë. Po ashtu, sipas nesh, cilësi të tjera të qytetarëve aktiv janë: respekti ndaj qytetarëve të tjerë dhe empatia. Empatia është aftësia për të bashkëndjerë me të tjerët. Kjo mund të jetë bazë e demokracisë.

Ndërsa, veprimet që i bëjnë qytetarët aktiv janë: pjesëmarrja në punën vullnetare, pjesëmarrja në organizata të ndryshme, krijimi i grupeve të ndryshme që për qëll-



Ne jemi ata që e kemi shkruar këtë artikull

SHEMBUJ NGA QYTETARIA AKTIVE

Në vjim do të keni mundësi të mësoni se si lidhet pjesëmarrja jonë në Punëtorinë e Demokracisë „Demos-ti“ me qytetarinë aktive. Po ashtu, të bashkangjitur do t’i gjeni edhe disa vizatime që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me veprimet e qytetarëve aktiv

Pjesëmarrja jonë në këtë Punëtori, lidhet me qytetarinë aktive. Informatat e marra këtu, ne do ti shpërndajmë tek shokët dhe shoqet e tjera. E tërë kjo do të ndikoj që të bëjmë një rreth më të gjerë të qytetarëve, të informuar mbi vlerat dhe rëndësinë e të jetuarit në demokraci. Kjo për arsye se ne e dijmë sesa i rëndësishëm është informimi i qytetarëve për vlerat demokratike. Këto vlera na e kanë bërë jetën shumë më të lehtë dhe me shumë të drejta. Prandaj, ne kemi vendosur se përveç që do ti shpërndajmë informatat në mënyrë verbale, ato t’i shkruajmë në këtë gazetë dhe kjo do të mbeten dëshmi edhe për shumë gjenerata të tjera që do të vin pas nesh. Jemi të lumtur që e kemi një mundësi të tillë, prandaj titulli i gazetës sonë është: „Lapsi është gjuha e mendjes“.



Këtu kemi dashur të paraqesim se sa e rëndësishme është të bëhet ndarja e mbeturinave dhe klasifikimi i tyre për nga materiali përbërës. Kështu, dallohen materialet që janë të reciklueshme

Përfaqësuesit tanë flasin për neve dhe marrin vendime në emrin tonë




Përfaqësuesi i grupit i paraqet idetë që ne i kemi



Libri, mjet i rëndësishëm informimi



Qytetarët përdorin biçikletat, që ta ruajnë ambientin



Qytetarët aktiv i respektojnë rregullat e komunikacionit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Andon Zako Çajupi“
Klasa: V-4
Vendi: Vushtrri